



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 1784/114 Prot.

Pogradec, më 05.05.2026

VENDIM

NR. 63, DATË 30.04.2026

PËR  
RISHQYRTIMIN E TARIFAVE TË PARKIMEVE QË DO TË APLIKOJË  
SHOQËRISË POGRADECI INVEST SHPK, PËR VITIN 2026.

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "f" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike"; neni 35 i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; shkronja "f" e nenit 7 të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; me propozim të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratohen tarifat e parkimeve për vend parkimet publike me pagesë si më poshtë vijon:

1.1 Tarifa e parkimit tek ish – Terminali:

NR	EMËRTEJA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS	
			ISHTE	BËHET
1	Tarifa për parkimin e automjeteve në Ish - Terminali	Lekë/orë	50	100



*Kanelli*

1.2 Tarifa e parkimeve në parkimet publike në pronësi të Bashkisë Pogradec:

NR	EMËRTESA E TARIFËS	NJËSIA	VLERA E TARIFËS			
			ISHTE	BËHET		
1	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, në pronësi të bashkisë Pogradec	Lekë/orë	50	50		
2	Tarifa për automjetet në parkimet publike me pagesë, gjatë sezonit turistik 15 Qershor – 15 Shtator, përgjatë Bulevardit , “Reshit Collaku” dhe “10 Dëshmorët e Pojskës”.	Lekë/orë	50	100		
3	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare pranë biznesit të vet.	Lekë/vit	36 000	8 orë (8:00 - 16:00)	12 orë (8:00 – 20:00)	24 orë (00:00- 24:00)
				36 000	45 000	72000
4	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjektet tregtare me objekt veprimtarie, “Hotel”.	Lekë/ Vit	36 000	72 000		
5	Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për banorët pranë shtëpisë së vet.	Lekë/3 muaj	0	9 000		
		Lekë/6 muaj	0	18 000		
		Lekë/12 muaj	0	36 000		
5	Tarifë për parkim për banorët, për parkim të automjetit brenda zonën së vet ku jeton.	Lekë/12 muaj	1000	1000		



*Handwritten signature*

2. Të miratohen kerkesat e mëposhtme:

2.1 Aksi i Zonës Industriale, të behet parkim me pagesë deri në momentin e kthimit të këtij aksi me dy kalime.

2.2 Përveç dy zonave të miratuara për parkim 1, dhe 2, të shtohet edhe dy zona të tjera në qytetin e Pogradecit 3, 4 në të cilat të behet vijezi i parkimeve, vendosja e tabelave dhe të shërbejnë si zona parkimi për rezidentët, sipas hartave bashkëngjitur Vendimit të Këshillit Bashkiak.

3. Efektet: Vendosja e tarifave të parkimit synon rregullimin e fluksit të mjeteve, disiplinimin e përdoruesve të hapësirave publike dhe garantimin e një përdorimi të drejtë dhe efikas të tyre.

4. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, dhe Administrata e Shoqërisë, Pogradeci Invest Shpk.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

6. U shpall sot më datë 30 04 .2026.

KRYETARE E KËSHILL  
Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 18 vota

2. Vota Pro 18

3. Vota Kundër 4

4. Vota Abstenim 2

5. Zbardhur më date 30.04.2026

-----